

UDHËZIM
Nr. 10, datë 19.1.2023

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 207, DATË 28.10.2022, “PËR
PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 46 dhe 50 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 207, datë 28.10.2022, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas pikës 3 të udhëzimit, shtohet pika 3/1 me përmbajtje, si më poshtë:

“3/1. Caktimin e zgjedhësve në listën e qendrës së votimit përkatëse, sipas kodit të vendbanimit. Renditja e zgjedhësve brenda qendrës së votimit bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit.”.

2. Pas pikës 11 të udhëzimit shtohet pika 11/1 me përmbajtje, si më poshtë:

“11/1. Procedura e parashikuar në pikën 3/1 të këtij udhëzimi kryhet për çdo ekstrakt të listës së zgjedhësve që do të hartohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi